



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 142- Shtator 2015 - ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/>



Pamja e re sallës së mbledhjeve të Kuvendit të Komunës së Malishevës

Përmbajtja:

KK i Malishevës, miratoi dy kërkesa për ndërrim destinim të tokës	3
Krasniqi: Kufijtë buxhetor të përcaktuar në MEF-i, pengojnë punën e komunave	3
Shitësit respektojnë urdhëresën për mosekspozim të mallit jashtë lokaleve	4
Kryetari Begaj, uron nxënësit me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor	4
Dosja e krimeve të luftës në Malishevë, i dorëzohet Institutit për Hulumtimin e Krimeve të Luftës	5
KK i Malishevës miratoi projekt-Rregulloren për ndarjen e subvencioneve dhe transferove.....	6
Shqetësuese rastet e zjarreve në dy muajt e fundit	6
Komunikatë	7
Komuna e Malishevës përkujton viktimat e 11 shtatorit 2001 në SHBA.....	9
Shënohet Dita e Rinisë në Malishevë.....	9
Ulet niveli i gatishmërisë në raport me EHKK	10
Komuna investon në aparaturën e QKMF-së.....	11
Krasniqi: Buxhetin për vitin e ardhshëm do ta bëjmë në dy versione	12
Komisioni për Arsim i Kuvendit të Kosovës, qëndroi në Malishevë.....	13
Kryetari Begaj, priti palët	14
Vazhdojnë përpjekjet e komunës në sigurimin e ujit për fshatin Pagarushë	14
Këshilli i Drejtorëve, mbajti takimin e rregullt	15
U mbajt tryeza “Buxheti i Komunës së Malishevës dhe perspektiva gjinore”	16
Shitja e kafshëve për kurban, bëhet vetëm në tregun kafshëve	17
KKSB e Malishevës, e vlerësoi të mirë sigurinë e përgjithshme	17
Kryetari Begaj, uron besimtarët islam me rastin e “Kurban Bajramit”	18
Kryetari Begaj, priti komandantin italian të KFOR-it, kolonelin Ciro Forte	19
Brenda javës, zyrat e ofiqarisë në Malishevë me pamje të re	19
Kryetari Begaj, takoi banorët e Drenocit	20
KK i Malishevës vazhdon me përkrahjen për familjet e dëshmorëve.....	21
Malisheva miratoi buxhetin me vërejtje sipas nevojave të komunës	22
Në 17 vjetorin e rënies përkujtohet dëshmori dr.Shpëtim Robaj.....	23
KK i Malishevës, kundër formimit të Asociacionit të Komunave Serbe	24

KK i Malishevës, miratoi dy kërkesa për ndërrim destinim të tokës

Malishevë, 1 shtator



Kuvendi i Komunës së Malishevës, i drejtuar nga kryesuesi i saj, z.Aziz Thaçi, dje deri në orët e vona të pasdites, ka mbajtur pjesën e parë të mbledhjes së tetë të këtij viti, ku ka shqyrtuar pesë kërkesa të ndryshe, e dy prej tyre i ka aprovuar, e të cilat kanë të bëjnë me ndërrim destinim të tokës, nga ajo bujqësore në tokë ndërtimore.

Fillimisht, kuvendi në mbledhjen e saj, ka refuzuar dy kërkesa që kishin të bëjnë me iniciimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës publike me qëllim të investimeve të kapaciteteve prodhuese, përkatësisht për kërkesën e parë, një pjesë e anëtarëve të KK, braktisën sallën në momentin e votimit, duke shkaktuar mungesë kuorumi, ndërsa në rastin e dytë, me shumicë votash e kanë refuzuar.

Po ashtu, KK i Malishevës, me shumicë votash refuzuan edhe iniciimin e procedurave për kushtëzimin e shërbimeve komunale, me përjashtim të atyre të gjendjes civile, me rastin e mospagesë së faturave për mbledhjen e mbeturinave.

Seanca e tetë, pritet që gjatë javës të vazhdoj punimet me trajtimin e pikave tjera që janë në rend dite.

Krasniqi: Kufijtë buxhetor të përcaktuar në MEF-i, pengojnë punën e komunave

Malishevë, 1 gusht

“Kufijtë buxhetor që i ka përcaktuar Ministria për Ekonomi dhe Financa, e pengojnë e punën e komunave”, kështu ka deklaruar drejtori për Ekonomi dhe Financa, në Komunën e Malishevës, z.Vesel Krasniqi, gjatë radio debatit në radio “Theranda”, lidhur me qarkoret buxhetore për buxhetin 2016-2018.



Përndryshe, ky radio debat, është organizuar nga misioni i OSBE-së në Kosovë, për komunat e regjionit të Prizrenit. Qëllim i këtij radio debati, ishte promovimi i pjesëmarrjes së aktive publike, përmes propozime të projekteve në hartimin e buxhetit komunal.

Lidhur me këtë temë, drejtori Krasniqi, tha se “Komuna e Malishevës, si rezultat i pjesëmarrjes jo të kënaqshme të publikut në debatet publike, ka praktikuar edhe formën komunikimit direkt, ku komuna zhvillon takime të ndryshme me qytetarët nëpër vendbanimet e tyre, me qëllim të marrjes së opinioneve dhe kërkesave të tyre, ku përmes kësaj komuna e bën planifikimin dhe orientimin e buxhetit, në veçanti në investimet kapitale”.

Kjo praktikë, e Komunës së Malishevës, në këtë debat, është vlerësuar edhe zyrtari i KDI-së.

Shitësit respektojnë urdhëresën për mosekspozim të mallit jashtë lokaleve

Malishevë, 1 shtator

Nga sot ka filluar zbatimi i urdhëresës së inspektoratit komunal, për mos ekspozim të mallit jashtë lokaleve të tyre afariste. Sipas shërbimit të inspektoratit, kjo urdhëresë, është duke u zbatuar nga shumica dërmuese e lokaleve, të cilët nuk po e ekspozojnë mallin jashtë objekteve të tyre.

Bardhyl Buçaj, shef i inspektorëve, ka deklaruar se “mbi nëntëdhjetë për qind e shitësve janë duke e zbatuar këtë urdhëresë të inspektoratit dhe gjatë vizitave të sotme në terren, kemi vërejtur se shitësit, janë duke e zbatuar këtë”.

“Atyre të cilët nuk e kanë zbatuar këtë urdhëresë, ju kemi dhënë vërejtjet e fundit dhe na nesër, asnjë shitës, nuk guxon ta ekspozoj mallin jashtë objektit, përkatësisht nuk guxon që malli për shitje të jetë i ekspozuar në ambient të hapur”, tha Buçaj.

“Kjo bëhet me qëllim të mbrojtjes së konsumatorit dhe vëmendje e veçantë ju kushtohet gjërave ushqimore, por edhe gjërave tjera, të cilat konsumatori i blen”, tha Buçaj.

Kryetari Begaj, uron nxënësit me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor

Malishevë, 1 shtator

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor 2015-2016, i ka uruar të gjithë nxënësit dhe mësimmshënësit, duke ju uruar një vit të mbarë dhe të suksesshëm në këtë vit shkollor.

“Uroj të gjithë nxënësit e Komunës së Malishevës, në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme, me rastin e fillimit të këtij viti shkollor dhe ju dëshiroj suksese të gjithëve. Në mënyrë të veçantë i përshëndes dhe i uroj të gjithë ata nxënës, të cilët për herë të parë janë ulur në banka shkollare, duke ju dëshiruar fillim të mbarë në klasën parë”, thuhet në urimin e Kryetarit të Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, drejtuar nxënësve dhe mësimitdhënësve të Komunës së Malishevës.

Dosja e krimeve të luftës në Malishevë, i dorëzohet Institutit për Hulumtimin e Krimeve të Luftës

Malishevë, 4 shtator

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, pas takimeve paraprake, sot edhe zyrtarisht, i ka dhënë Institutit për Hulumtimin e Krimeve të Luftës në Kosovë, dosjen e krimeve, dëmeve, krimeve dhe të gjenocidit të ushtruar në Malishevë, gjatë viteve 1998-1999, të kryera nga ushtria, policia dhe paramilitarët e shtetit serb.



Për këtë qëllim, kryetari Begaj, sot ka pritur në një takim pune, zyrtarin e lartë të këtij institucioni, z.Abedin Selimaj, të cilit edhe ja ka dorëzuar dosjen që dëshmon për krimet e luftës në territorin e Komunës së Malishevës.

Në këtë dosje, përfshihen, të vrarët, të zhdukurit, masakrat, dëmet në ekonomitë familjare, dëmet në institucionet publike dhe dëmet në sektorin e biznesit.

Instituti për Hulumtimin e Krimeve të Luftës në Kosovë është institucion publik hulumtues me qëllim të mbledhjes, sistematizimit, përpunimit dhe publikimit të dhënave për krime kundër paqes, krime të luftës, krime kundër njerëzimit dhe akteve të gjenocidit të kryera në Kosovë gjatë vitit 1998, deri në qershor të vitit 1999 dhe vepron në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

KK i Malishevës miratoi projekt-Rregulloren për ndarjen e subvencioneve dhe transferove

Malishevë, 4 shtator

Kuvendi i Komunës së Malishevës, i drejtuar nga kryesuesi i saj, z.Aziz Thaçi, sot ka vazhduar pjesën e dytë të mbledhjes së tetë të këtij viti, ku ka shqyrtuar raportin e dy drejtorive komunale për vitin 2015, ka miratuar projekt-Rregulloren për ndarjen e subvencioneve dhe një kërkesë të parashtruar nga drejtoria për Urbanizëm.

Fillimisht gjatë kësaj mbledhje drejtori për Ekonomi dhe Financa z.Vesel Krasniqi, ka raportuar për raportin e të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Qershor 2015, ku më pas është shqyrtuar nga ana e anëtarëve të KK-së, pastaj është shqyrtuar edhe raporti i DKA-së të të njejtës periudhë ku raportin e prezantoi drejtoi i Drejtorisë për Arsim z.Blerim Thaçi.

Po ashtu, KK i Malishevës ka shqyrtuar dhe miratuar me shumicë votash edhe projekt-Rregulloren për ndarjen e subvencioneve dhe transfereve, pastaj është miratuar edhe kërkesa e parashtruar nga drejtoria e Urbanizmit, për lirim nga taksat për leje urbanistike, për të gjithë fermerët, jo vetëm për ata që marrin subvencione por për se cilin që ka për qëllim të ndërtoj një fermë duke respektuar rregullat dhe ligjet të lirohen nga taksat për ndërtim.

Shqetësuese rastet e zjarreve në dy muajt e fundit

Malishevë, 7 shtator

Sot në mbledhjen e Këshillit të Drejtorëve, të drejtuar nga nënkryetari i Komunës së Malishevës, z.Rexhep Mazreku, janë shqyrtuar një varg çështjesh që lidhen punët e përditshme të drejtorive komunale, ndërsa si shumë shqetësuese u prezantuan rastet e shumta të zjarreve në dy muajt e fundit, që kanë ndodhur në territorin e Komunës së Malishevës.

Sipas drejtorit të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, z.Ahmet Morina, gjatë dy muajve të fundit “kanë ndodhur 204 raste të zjarreve, ku është dashur ndërhyrja e njësisë së zjarrfikësve dhe shpëtimit, ndërsa zjarret në përgjithësi kanë qenë zjarre të mëdha”. Drejtori Morina, po ashtu tha se, “zjarri i ndodhur në varrezat e fshatit Panorc, është përcjellë me dëme të mëdha, ku sipas banorëve, kjo ka ardhur si pasojë e rënies së telave të rrymës”.

Në mbledhjen e sotme, mes tjerash u njoftua edhe për situatën epidemiologjike, ku sipas drejtorive përkatëse, është hera e parë kur në dy vite radhazi, nuk janë shënuar vdekje nga ethet hemorragjike, kurse këtë vit, edhe më e mira ka qenë, që nuk ka pasur as raste të infeksionit me EHKK, si dhe numri i rasteve të thumbuara, ka qenë gati përgjysmë më pak.

Në këtë situatë përveç faktorëve tjerë, u tha se ka ndikuar edhe repelimi i kafshëve, që pritet të përfundoj gjatë kësaj jave edhe faza e fundit e repelimit.

Sa i përket procesit mësimor, sipas drejtorit të arsimit, z.Blerim Thaçi, sot ka filluar procesi mësimor në shkollën “Xhevë Lladroci” në Drenoc, me një javë vonesë për shkak të disa renovimeve në objektin e shkollës, si dhe në gjimnazin “Hamdi Berisha”, po ashtu, sot pritet të filloj procesi mësimor, ndërsa java e humbur e mësimimit, do të kompensohet.

Kurse projektet e ndryshme, sipas drejtorive përkatëse, janë duke vazhduar sipas planifikimeve, me ndonjë ngecje të vogël, por në përgjithësi, projektet janë duke vazhduar, ndërsa me 15 shtator, pritet të përfundojnë punimet komplete në objektin e shkollës “Imer Krasniqi” në Carrallukë.

.....

Komunikatë

Nga: Komuna e Malishevës

Për: Medie dhe opinion e gjerë publik

Lënda: Komunikatë

Ndërhyrjet me veprime jo ligjore të AAAPARr në Qendrën e Kompetencës e cenojnë rëndë zhvillimin e arsimit parauniversitar

Duke u bazuar në rrethanat e krijuara në Qendrën e Kompetencës në Malishevë , konsiderojmë që fillimi i punës në këtë Institucion Arsimor është duke u përballur me vështirësi të cilat cenojnë integritetin e sistemit arsimor, cenojnë ligjin për arsimin parauniversitar dhe kufizojnë përpjekjet dhe angazhimin për definimin e arsimit profesional.

Duke besuar në perspektivën dhe angazhimin institucional që arsimit profesional të konsolidohet dhe të punoj në drejtim të hapjes së programeve dhe zbatimit të strategjisë kombëtare për arsimin profesional, edhe Komuna e Malishevës u bë pjesë e bashkëpunimit institucional që Qendra e Kompetencës të jetë pjesë e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Agjencionin për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin e të Rriturve (AAAPARr) dhe e përkrahur nga GIZ- organizatë gjermane.

Por shumë shpejt jemi gjetur në situatë jo bashkëpunuese të cilën e reflektoj AAAPARr. Kjo u bë e evidente kur ky institucion fillojë të paraqes veprime të cilat kanë tendencë politike dhe cenojnë ligjin për arsimin parauniversitar. Veprimet e kësaj agjencie reflektojnë menjëherë dhe po reflektojnë që synimi i këtij agjencioni ishte jo transparenca dhe jo gjithëpërfshirja, e mosrespektimi i ligjit për arsimin parauniversitar, por siç duket arritja e synimeve të ngushta të menaxhmentit të saj. Me veprimet e kësaj natyre është cenuar integriteti i marrëveshjes. Zbatimi i saj është rrezikuar që disa muaj nga AAAPARr, duke përdorur veprime, të cilat e dëmtojnë punën e këtij institucioni arsimor të shumëpritur në Komunën e Malishevës dhe cenojnë ligjin për arsimin parauniversitar.


Komuna e Malishevës ka ndërmarrë veprime të cilat kanë pasur për qëllim të bëjnë të mundur tejkalimin e problemeve të krijuara me nevojat për punësimin e kuadrit arsimor. Zhvillim tjetër shokues nga përkrahja e kësaj marrëveshje ka qenë edhe tërheqja prej përkrahjes nga GIZ -organizatë gjermane, e cila i ka dhënë jetë marrëveshjes sonë . Duke parë këtë largim të GIZ dhe rrethanat e krijuara të cilat kanë cenuar ligjin për arsimin parauniversitar, komuna e Malishevës po ashtu ka tërhequr nënshkrimin nga Marrëveshja e Bashkëpunimit dhe ka realizuar disa takime me autoritetet arsimore të Ministrisë së Arsimit dhe Agjencisë për Arsimin dhe Aftësimin Profesional. Edhe këto takime sipas reagimeve të tanishme kanë rezultuar të pa dobishme.

Vlerësojmë përfundimisht se Marrëveshja e Bashkëpunimit është e shkëputur dhe e paimplementueshme, nuk ka mundësi të vazhdohet deri në një zhvillim tjetër, i cili do të jetë gjithëpërfshirës dhe cilësor. Po ashtu i bëjmë me dije MASHT-it se duhet të ndërmarrë veprime të shpejta, të evitohet ndërhyrjet, të cilat cenojnë arsimin parauniversitar dhe dëmtojnë procesin e vetëqeverisjes lokale dhe pamundësojnë zbatimin e ligjit për arsimin parauniversitar. Kërkojmë nga AAAPARr që të mos ndërhyjë në kompetencat e Komunës së Malishevës dhe të mos dëmtojë vijueshmërinë e procesit edukativo arsimor në Qendrën e Kompetencës, duke sjellë personel arsimor i nxjerrë nga konkurse jo ligjore, kjo edhe pas tërheqjes së nënshkrimit të kryetarit të Komunës së Malishevës nga Marrëveshja e Bashkëpunimit.

Komuna e Malishevës do të vazhdojë të jetë dhe është kompetente në trajtimin e problemeve të krijuara në arsimin profesional dhe kjo gjithmonë në zbatim të ligjit për arsimin parauniversitar. Po ashtu do të jemi të përkushtuar që të jemi pjesë e bashkëpunimit në të ardhmen me të gjitha institucionet kredibile arsimore brenda dhe jashtë vendit, dhe kjo vetëm në suaza të përkushtimit me veprime cilësore gjithëpërfshirëse dhe ligjore.

Komuna e Malishevës përkujton viktimat e 11 shtatorit 2001 në SHBA

Malishevë, 11 shtator



Nxënësit e ShFMU "Ibrahim Mazreku" në Malishevë, me ndihmën e drejtorisë dhe arsimtarëve të shkollës, sot kanë përkujtuar dhe janë solidarizuar me familjarët e viktimave të 11 shtatorit të vitit 2001 në SHBA, me sloganin “Yes We Can, Yhank You Amerika, We never forggt you”. Në këtë nderim morën pjesë Nënkryetari i Komunës së Malishevës, z.Rexhep Mazreku, drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, znj.Blertha Krasniqi, drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, z.Blerim Thaqi, dhe mysafiri i veçantë në këtë ngjarje ishte themeluesi i shoqatës "Miqtë e Amerikës", z.Agim Rexhepi.

Shënohet Dita e Rinisë në Malishevë

Malishevë, 12 shtator



Në kuadër të “Muajit të Rinisë në Kosovë”, Dita e Rinisë, sot është shënuar në Malishevë, përmes aktiviteteve të të shumta rinore, kulturore e sportive, të cilat janë organizuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, në bashkëpunim me KVRL-në, Qendrën Rinore, Kryqin e Kuq dhe OSBE-në.

Në këto aktivitete, kanë marrë pjesë edhe nënkryetari i Komunës s Malishevës, z.Rexhep Mazreku dhe drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, të cilët edhe i kanë uruar të rinjtë malishevas, me rastin e shënimit të kësaj date për rininë. Mazreku dhe Krasniqi, i kanë përgëzuar të rinjtë për këto aktivitete, si për punën vullnetare që po bëjnë këta rinj.

Aktivitetet kane filluar në orën 10:30, në Qendrën e Rinisë. Fillimisht është zhvilluar një debat për problemet dhe sfidat e të rinjve në vendimmarrje, më pas është zhvilluar turniri sportiv në të cilin kanë marrë pjesë dhjetë ekipe. Fitues i vendit të parë në turnir është ekipi nga Llozica, fitues i vendit të dytë ekipi nga Malisheva, gjithashtu edhe vendit e tretë e fitoi ekipi nga Malisheva. Aktivitetet kanë vazhduar me shfaqje të filmave dokumentar realizuar

nga Dokufesti, pastaj aktiviteti me vizatime dhe piktura. Dita e Rinisë përmbillet me mbrëmjen rinore me DJ në Parkun e qytetit, në orën 19:00.

Ulet niveli i gatishmërisë në raport me EHKK

Malishevë, 14 shtator

Për shkak të uljes së numrit të rasteve të thumbimit nga rriqrat, si dhe asnjë rast i infektuar me ethe hemorragjike krime kongo, ka bërë që institucionet shëndetësore të fillojnë të ulin nivelin e gatishmërisë në raport me EHKK, përkatësisht është shkurtuar orari i punës së laboratorit, i cili deri më tani ka punuar deri në ora 22:00, kurse tani punon deri në ora 15:00. Ndërsa gatishmëria në shërbimin emergjencës, për trajtimin e rasteve eventuale të thumbimeve, vazhdon të jetë në nivel të njëjtë.

Kështu ka deklaruar sot, drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Hajdin Berisha, në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve. Përndryshe, drejtori Berisha deklaroi se në QKMF të Malishevës, është shënuar një numër rekord i numrit të pacientëve, gjatë muajit gusht, ku sipas tij, “për shkaqe të ndryshme, duke filluar nga temperaturat, numri i madh i ahengjeve familjare dhe të tjera, në QKMF janë trajtuar mbi 24 mijë pacient gjatë muajit gusht”.

Ndërsa në aspektin e sigurisë së përgjithshme, përkatësisht numrit të zjarreve, sipas drejtorit të Drejtorit të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, ka rënie të dukshme të rasteve të zjarreve, ndërsa e vlerësoi lartë punën e pjesëtarëve të Shërbimit të Zjarrfikësve dhe Shpëtimit, t cilët, në 204 raste të ndërhyrjeve gjatë dy muajve të fundit, nuk kanë marrë asnjë ankesë nga qytetarët.

Përndryshe, edhe drejtoritë tjera kanë raportuar për punët e kryera gjatë javës së kaluar, ku sipas drejtorive, kanë vazhduar punimet në shumë projekte, si dhe po bëhen planifikimet për projektet dy vjeçare, pastaj po kryhen inspektimet e rregullta, përgatitja e buxhetit komunal, projekt buxhe ti cili është përgatitur dhe është dërguar për shqyrtim në Komitetin për Politikë dhe Financa (KPF), si dhe për organizimin e të shtunës të Ditës së Rinisë, në kuadër të Muajit të Rinisë në Kosovë.

Komuna investon në aparaturën e QKMF-së

Malishevë, 16 shtator



Në kuadër të përpjekjeve të Komunës së Malishevës, për ofrimin e shërbimeve më të mira shëndetësore për qytetarët e saj dhe të krijimit të kushteve më të mira për punë, Komuna ka investuar në blerjen e aparaturës në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr. Shpëtim Robaj” në Malishevë, si dhe është duke u investuar në ulëset për pacient në korridorin e qendrës kryesore shëndetësore në Malishevë.

Këto investime në QKMF të Malishevës, i kanë parë nga afër edhe Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Ragip Begaj dhe drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, z. Hajdin Berisha, ku janë njoftuar me këtë aparaturë dhe me kushtet në përgjithësi në QKMF.

Begaj dhe Berisha, i kanë uruar menaxhmentin dhe punëtorët shëndetësor të QKMF-së për këto pajisje, të cilat i ndihmojnë punëtorët në kryerjen e detyrave të tyre dhe ofrimin e shërbimeve më të mira për pacientët në nevojë.

Nga ana tjetër edhe drejtori i QKMF-së, z. Besim Zogaj, e ka falënderuar komunën për këto investime, shumë të rëndësishme, pasi tani pacientët, shumë analiza dhe kontrole tjera mjekësore, do të kryejnë brenda QKMF-së, pa pasur nevojë të shkojnë në qendra tjera spitalore, pasi këto pajisje janë moderne dhe kryejnë shumë shërbime.



Përndryshe, me këto pajisje të cilat kapin një shumë në mbi njëzetekatër mijë euro, QKMF e Malishevës, është pajisur me një defribilator, analizator bio-kimik dhe një aparat modern i ultrazërit me ngjyra.

Drejtori komunal për shëndetësisë, z. Hajdin Berisha, tha se “përveç kësaj aparature, jemi duke rregulluar edhe ambientet e pritjes së pacientëve, ku po ndërrohen ulëset në korridorin e QKMF-së, në mënyrë që të gjithë ata pacient, apo përcjellës të tyre, ti ndihen rehat gjatë vizitave të tyre në qendrat mjekësore”. Po ashtu Berisha tha se “investimet në fushën e shëndetësisë, do të vazhdojnë, pasi Komuna e Malishevës, është komuna që më së largu i ka qendrat spitalore, prandaj është shumë e nevojshme që të ofrohen sa më shumë shërbime mjekësore në QKMF”.

Krasniqi: Buxhetin për vitin e ardhshëm do ta bëjmë në dy versione

Malishevë, 18 shtator

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), organ i Kuvendit të Komunës së Malishevës, i drejtuar nga kryesuesi, z.Aziz Thaçi, ka mbajtur sot mbledhjen e nëntë të radhës për këtë vit, ku janë trajtuar një varg çështjesh, si dhe janë dhënë disa rekomandime për shqyrtim në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës, në mesin e të cilave, edhe projekt buxheti komunal 2016-2018.

Projekt buxhetin e Komunës së Malishevës, 2016-2018, para anëtarëve të KPF-së, e ka prezantuar drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, z.Vesel Krasniqi, i cili edhe i ka sqaruar se pesë linja buxhetore, janë të prera nga ana e Ministrisë së Financave, për cilat, siç tha drejtori Krasniqi, “nuk jemi pajtuar, pasi e dëmtojnë seriozisht buxhetin komunal, prandaj ne si drejtori i kemi përgatitur dy versione të projekt buxhetit, njërin sipas kufijve të caktuara nga ministria, ndërsa tjetrin sipas nevojave të Komunës së Malishevës dhe të dy versionet do të dërgohen në Kuvend të Komunës dhe në Ministrinë për Financa”.

Ndërsa për investimet kapitale, Krasniqi, i ka sqaruar anëtarët e KPF-së, me organizimet e debateve publike, takime me liderët e fshatrave dhe format tjera të debatit publik, përmes së cilave janë nxjerrë edhe prioritetet për investimet kapitale për vitin 2016.

Përveç projekt buxhetit, KPF ka rekomanduar për mbledhjen e ardhshme të KK-së edhe projekt rregulloren për tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin 2016, pastaj ka shqyrtuar edhe raportin e DKAË për përfundimin e vitit shkollor 2014/15 dhe përgatitjet për fillimin e vitit shkollor 2015/16.

KPF ka shqyrtuar edhe raportin vjetor të punës për vitin 2014, raporti financiar Janar-Dhjetor 2014, dhe plani operativ 2015/2016 i K.R.M “Ekoregjioni” Prizren, njësia operative në Malishevë, pastaj raportin vjetor të punës për vitin 2014, planifikimi për vitin 2015 i K.R.U “ Hidroregjioni Jugor” SH.A Prizren, njësia operative në Malishevë dhe raportin financiar për vitin 2014, si dhe raporti financiar pesë mujor për vitin 2015, i Stacionit të Autobusëve në Malishevë.

Komisioni për Arsim i Kuvendit të Kosovës, qëndroi në Malishevë

Malishevë, 18 shtator



Me ftesë të Kryetarit të Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, sot në Malishevë, ka qëndruar Komisioni për Arsim i Kuvendit të Kosovës, i drejtuar nga kryetari i këtij komisioni z.Nahit Hasani, anëtarët znj.Teuta Haxhiu, z.Ismail Kurteshi, z.Salih Morina dhe znj.Shukrije Bytyçi, ndërsa atëherë ishte i pranishëm edhe deputeti z.Enver Hoti. Qëllimi i këtij takimi, ishte njoftimi i komisionit për gjendjen në arsim në

Malishevë, përkatësisht në Qendrën e Kompetencës.

Fillimisht kryetari Begaj, i njoftoi komisioni lidhur me situatën e krijuar në Qendrën e Kompetencës, problemet me Agjencionin për Arsimin Profesional dhe Arsimin për të Rritur, ku në mënyrë kronologjike i njoftoi, për marrëveshjen e bërë me këtë agjencion, arsyet e prishjes së marrëveshjes nga ana e Komunës së Malishevës, ku sipas kryetarit Begaj, “prej tërheqjes së GIZ-it nga ky projekt, Malisheva i ka pasur rezervat e veta, pasi agjencioni ka vepruar jo drejt në raport me nevojat e kësaj qendre të arsimit profesional dhe në kundërshtim me ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, ku komuna është përgjegjëse për arsimin parauniversitar”. Begaj i ka njoftuar anëtarët e komisionit për të gjitha problemet e deritanishme, si dhe ka kërkuar që kjo çështje të zgjedhjet drejt, sipas ligjit, me qëllim të ngritjes së arsimit, si dhe komisioni të shqyrtoj këtë çështje dhe të ndihmoj të bëhet një zgjidhje sa më e drejt e këtij problemi.

Edhe drejtori për Arsim dhe Edukim, z.Blerim Thaçi dhe drejtori i Qendrës së Kompetencës, z.Nazmi Zogaj, i kanë informuar anëtarët e komisionit për arsim, për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me problemin e Qendrës së Kompetencës në Malishevë, si dhe më pas janë përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të Komisionit për Arsim.

Nga ana tjetër, z.Nait Hasani, kryetar i këtij komisioni, tha se “i ka dëgjuar me vëmendje të gjitha ato që janë thënë dhe këtë çështje, premtori se do diskutoj në mbledhjen e së martës, të komisionit me ministrin e arsimit, z.Arsim Bajrami, si dhe do ta dërgojnë edhe në Kuvend të Kosovës, nëse është e nevojshme, në mënyrë që ky problem të zgjidhet sa më shpejt dhe sa më drejtë, me qëllim të ecjes përpara dhe zhvillimit të arsimit profesional në vend”

Kryetari Begaj, priti palët

Malishevë, 18 shtator

Si çdo të premtë, edhe sot, i pari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, priti palët, duke e vazhduar traditën e takimeve të drejtpërdrejta me qytetarët dhe njohja me problemet dhe nevojat që kanë qytetarët, si në rastet individuale, ashtu edhe në ato kolektive apo të komunitetit.

Në gjitha rastet e pritjes së sotme, kryetari Begaj, i ka dëgjuar dhe i ka ofruar ndihmën e nevojshme të Komunës, apo këshillat e nevojshme për zgjidhjen e probleme të ndryshme, me të cilat, qytetarët ballafaqohen.

Vazhdojnë përpjekjet e komunës në sigurimin e ujit për fshatin Pagarushë

Malishevë, 19 shtator



Komuna e Malishevës, është duke vazhduar përpjekjet e saj, për rritjen e mirëqenies së qytetarëve. Në kuadër të kësaj, janë edhe investimet në sigurimin e ujit për pije, që në të njëjtën kohë është edhe një prej prioriteteve të Kryetarit të Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, i cili sot vizitoi punimet që janë duke u bërë në fshatin Pagarushë, në kuadër të përpjekjeve për gjetjen e ujit të mjaftueshëm me qëllim të ndërtimit të ujësjellësit për këtë fshat.

Shpimet në kërkim të ujit, që janë duke u bërë në Pagarushë, deri më tani kanë dalë të suksesshme, pasi janë realizuar tri shpime të thella, dhe si rezultat ka dalë një sasi e mjaftueshme e ujit, sasi e cila besohet që do ta furnizoj mjaftueshëm këtë vendbanim. Këto kërkime për ujë, janë duke u bërë së bashku nga ana e Komunës së Malishevës dhe “Hidroregjionit jugor”.

Kryetari Begaj, i ka uruar banorët e fshatit Pagarushë, për gjetjen e ujit dhe tha se “qeveria komunale e cila drejtohet nga ai, do të vazhdojë përpjekjet për krijimin e një mirëqenie sa më të mirë për qytetarët e Komunës së Malishevës, në përgjithësi, e këtë rast edhe për banorët e Pagarushës”.

Nga ana tjetër banorët janë shprehur shumë të kënaqur edhe me gjetjen e ujit, por edhe me angazhimin e komunës dhe e kanë falënderuar kryetarin Begaj, për këtë angazhim.

Këshilli i Drejtorëve, mbajti takimin e rregullt

Malishevë, 21 shtator

Këshilli i Drejtorëve, i drejtuar nga Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, sot ka mbajtur takimin e rregullt të së hënës, ku drejtorët e drejtorive komunale, kanë raportuar për punët dhe aktivitetet e tyre, gjatë javës së kaluar dhe planifikimet e tyre për javën në vijim.

Në kë këtë mbledhje, drejtorët e drejtorëve përkatëse, thanë se realizimi i projekteve po vazhdon sipas planifikimeve, ndërsa shumë projekte të këtij viti, kanë përfunduar dhe disa projekte tjera dy vjeçare, janë në proces e sipër. Gjatë javës së kaluar ka pasur disa aktivitete kulturore dhe rinore, si dhe dy klube sportive të formuara kohëve të fundit, pritet të startojnë në garat e përcaktuar sipas federatave përkatëse.

Po ashtu, mësimi në të gjitha shkollat po vazhdon normalisht, përderisa po vazhdojnë renovimet nëpër disa shkolla, si dhe janë bërë përgatitjet për fillimin e furnizimit me lëndë djegëse për të gjitha shkollat e Komunës së Malishevës.

Edhe në shërbimet shëndetësore, çdo ditë e më tepër po investohet në mjete konkretizuese, me qëllim të ofrimit të shërbimeve më të mira për qytetarët e Komunës së Malishevës. Njëjtë është duke u vepruar edhe bujqësi, ku drejtorja përkatëse, pritet që gjatë kësaj jave të filloj me implementimin e tri projekteve, për furnizimin me makineri në fushën e pemëtarisë, në makina mjelëse dhe në koshere për bletarët.

Sa i përket sektorit të financave, u tha se deri më tani të gjitha projektet janë realizuar sipas planifikimeve buxhetore. Ndërsa kjo drejtori ka hartuar edhe projekt buxhetin 2016-2018, të cilin e ka dorëzuar në Kuvend të Komunës, i cili do të shqyrtohet në dy lexime në kuvend.

Në mbledhjen e sotme u bë e ditur, se gjatë javës së kaluar ka pasur nëntë raste të zjarreve, kurse sa i përket shërbimit të inspektoratit, u tha se tek tregu i gjelbër, është një problem me urën, e cila është e ngushtë dhe po shkakton edhe probleme në trafik, gjatë ditëve të tregut, ndërsa ekspozimi i mallrave nga subjektet afariste, po respektohet shumë mirë dhe malli nuk po ekspozohet jashtë lokaleve.

Sipas drejtorisë së administratës, me gjithë fluksin e madh të mërgimtarëve, të gjitha shërbimet janë kryer me sukses dhe nuk janë regjistruar ankesa. Ndërsa tek shërbimet publike, u bë e ditur se është riparuar ndriçimi publik në lagjen e “Gurit” në Malishevë.

U mbajt tryeza “Buxheti i Komunës së Malishevës dhe perspektiva gjinore”

Malishevë, 21 shtator



Organizuar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), sot në Malishevë, është mbajtur tryeza me temën: Buxheti i Komunës së Malishevës dhe perspektiva gjinore. Në këtë tryezë morën pjesë, përfaqësueset e grupit jo formal të grave anëtare të Asamblesë Komunale, zyra për barazi gjinore, drejtorja për buxhet dhe financa dhe përfaqësues të OJQ-ve lokale, ku u tha se “planifikimi buxhetor duhet të

shpërndahet edhe në aspektin gjinor’.

Fillimisht, drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, z.Vesel Krasniqi, sqaroi se programet apo vijat buxhetore, të cilat janë të përcaktuara nga ana e Ministrisë për Ekonomi dhe Financa, “nuk kanë ndonjë nën program, që do të dedikohet në fushën e barazisë gjinore, mirëpo ne si qeveri komunale, kemi planifikuar që përmes formave tjera, buxheti, apo shpërndarja e tij, të jetë sa më shumë i barabartë në aspektin gjinore dhe të gjitha OJQ-të, klubet apo gratë në biznes, do të përkrahen nga ana e komunës, në ushtrimin e veprimtarisë së tyre”.

Zyrtarja për barazi gjinore, znj.Vera Bytyçi, duke i prezantuar disa të dhëna, tha se numri i të punësuarve, në Komunën e Malishevës, është diskriminues në raport me gjininë femërore, pasi administratën komunale, numri i të punësuarave femra është 16 për qind, në shëndetësi është 48 për qind, ndërsa në numri i anëtareve femra në Asamblenë Komunale, është 35 për qind dhe paraqiti nevojën e avancimit të femrës në raport me punësimin dhe përkrahjen në fusha tjera të jetës.

Rreth pozitës së gruas në Malishevë, folën edhe anëtarët femra në Kuvendin e Komunës së Malishevës, sipas të cilave, falë angazhimit të tyre, në disa raste janë përkrahur gratë në aktivitete të tyre, mirëpo nuk guxon të ketë diskriminim gjinor në rastin.

Në fund të kësaj tryeze, nga ana e organizatorit, dolën edhe konkluzionet e nxjerra, ku sipas moderatorit të kësaj tryeze, Naim Cahanaj, duke u bazuar në diskutimet e bëra, duhet të ndihmohen me buxhet klubet sportive të femrave, pastaj si rekomandim,, duhet të merren masa për rritjen e numrit të të punësuarave femra në administratë, trajnime për gratë në edukimin jo formal, funksionalizimin e çerdhes publike dhe feramat nga grupi jo formal i grave në Asamblenë Komunale, femrat nga OJQ-të dhe grupet tjera të interesit, duhet të

takohen para miratimit të buxhetit komunal, në mënyrë që të ndikojnë në shpërndarjen e buxhetit në aspektin gjinor.

Shitja e kafshëve për kurban, bëhet vetëm në tregun kafshëve

Malishevë, 23 shtator



Drejtorja e Inspektoratit në Malishevë, sot ka bërë të ditur se shitja e kafshëve para festës së Kurban Bajramit, bëhet vetëm në tregun e kafshëve në afërsi të liqenit në Mirushë. Për këtë qëllim inspektorët komunal, nuk do të lejojnë shitjen e kafshëve në vende publike, në rrugët e qytetit në Malishevë.

Kështu ka deklaruar sot, drejtori i Drejtorisë së Inspektoratit në Malishevë, z.Sejdi Paçarizi, sipas të

cilit, pika e shitjes për kafshët të cilat shiten për kurban, do të bëhet sipas rregullave, dhe ato shiten vetëm në tregun e kafshëve, ndërsa të gjithë shitësit e kafshëve, duhet ta respektojnë këtë rregull.

Sipas inspektorëve komunal, të gjithë shitësit, me ndonjë përjashtim, të cilët nuk kanë qenë të informuar, po e respektojnë këtë rregull dhe shitja e kafshëve po bëhet në tregun e kafshëve, kurse rasteve të cilat nuk kanë të qenë informuar, po njoftohen dhe po largohen kafshët nga vendet ku nuk lejohet shitja e tyre.

Përndryshe, sipas inspektoratit komunal, gjatë ditës së nesërme, nuk do të ketë ndonjë therje të organizuar të kafshëve për Kurban Bajram.

KKSB e Malishevës, e vlerësoi të mirë sigurinë e përgjithshme

Malishevë, 23 shtator

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), sot ka mbajtur takim e rregullt, ku është vlerësuar situata e sigurisë së përgjithshme në Komunën e Malishevës, situatë e cila u vlerësua e qetë, stabile dhe pa tendencë të prishjes së kësaj shtate, në të gjitha fushat e sigurisë.



Sipas nënkryetarit të Komunës së Malishevës, z.Raxhep Mazreku, “Kësaj situatë të mirë, i kanë kontribuar të gjitha organet e sigurisë në vend, si dhe organizatat jo qeveritare dhe organizmat tjerë, për çka ne i falënderojmë të gjithë”.

Komandanti i stacionit policor në Malishevë, kapiteni Halil Morina, duke u bazuar në raportet policore dhe statistikat

e krahasimit të veprave penale, aksidenteve dhe çështjeve tjera që lidhen me sigurinë e përgjithshme, tha se “situata e sigurisë është e mirë dhe pa indikacione për prishjen e kësaj situatë, e po ashtu edhe numri i veprave penale, ka shënuar rënie të dukshme, në raport me vitet tjera, dhe çdo vit po shkon drejt përmirësimit”.

Ahmet Morina, drejtor për Mbrojtje dhe Shpëtim, tha se këtë vit, situata me EHKK, ka qenë shumë stabile, dhe nuk kemi pasur, asnjë rast të infektuar me ethe hemorragjike. Morina po ashtu tha se edhe situata me zjarre, pavarësisht numrit të madh të zjarreve, ka qenë nën kontroll dhe intervenimet e njëjësive për shuarjen e zjarreve ka qenë në nivel të kënaqshëm, duke i kontribuar me këtë edhe sigurisë së përgjithshme për qytetarët e Komunës së Malishevës.

Në këtë mbledhje, zyrtarja komunale për çështje gjinore, znj.Vera Bytyçi, ka raportuar për gjendjen aktuale të barazisë gjinore, ku sipas raporteve të grumbulluara, pavarësisht se krahasuar me një dekadë më parë, gjendja e femrës është më e mirë, ka nevojë për më shumë përkrahje dhe avancim të femrës në të gjitha sektorët e jetës dhe punës, përfshi edhe udhëheqjen.

Kurse, sa i përket fillimit të vitit të ri shkollor 2015-2016, raportoi drejtori komunal për arsim, z.Blerim Thaçi, ku sipas tij mësimi zhvillohet normalisht dhe pa probleme të cilat do ta pengonin procesin mësimor. “Të gjitha shkollat janë në funksion dhe në gjendje të mirë, në aspektin e sigurisë dhe nuk janë shënuar raste të cilat do ta rrezikonin mësimin apo nxënësit”, tha drejtori Thaçi, duke folur për aspektin e sigurisë në shkolla.

Kryetari Begaj, uron besimtarët islam me rastin e “Kurban Bajramit”

Me rastin e festës së “Kurban Bajramit”, Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, i uron të gjithë besimtarët islam në Komunën e Malishevës. “Në emër të Komunës së Malishevës dhe në emrin tim, i uroj të gjithë besimtarët islam, me rastin e festës së Kurban Bajramit”. Uroj që kjo festë të jetë një moment i veçantë për të gjithë besimtarët dhe njerëzit

e vullnetit të mirë, që të shfaqin solidaritetin dhe humanizmin e tyre. E lus zotin, që njerëzit e sakrificës dhe familjet e tyre, ti shpërblej me të gjitha të mirat. Urime festa e Kurban Bajramit”, thuhet në urimin e kryetarit Begaj, drejtuar qytetarëve të Komunës së Malishevës.

Kryetari Begaj, priti komandantin italian të KFOR-it, kolonelin Ciro Forte

Malishevë, 25 shtator



Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Ragip Begaj, ka pritur sot në një takim njohës, komandantin e njësisë shumëkombëshe perëndimore të KFOR-it në Pejë, kolonelin Ciro Forte, me të cilin kanë biseduar për bashkëpunimin e ndërsjellë, mes KFOR-it italian dhe Komunës së Malishevës.

Kryetari Begaj e njoftoi kolonelin Forte, me situatën e përgjithshme në Komunën e Malishevës, popullsinë, infrastrukturën, arsimin, resurset e Komunës së Malishevës, si dhe e falënderoi KFOR-in italian dhe shtetin italian për përkrahjen e deritashme që i kanë dhënë vendit në përgjithësi dhe në veçanti Malishevës.

Koloneli Forte, pasi e falënderoi kryetarin Begaj për pritjen, tha se përveç njohjes, qëllim i kësaj vizite, është edhe rritja e bashkëpunimit të ndërsjellë mes KFOR-it, njësisive të saj dhe Komunës së Malishevës, jo vetëm në fushën e sigurisë, por në të gjitha fushat e jetës. Koloneli Forte, tha se KFOR-i italian, në kuadër të angazhimeve të tyre, kanë në plan edhe pjesëmarrjen në projekte të caktuara dhe janë të gatshëm të bashkëpunojnë edhe më ngushtë me Komunën e Malishevës.

Sa i përket situatës së sigurisë së përgjithshme në Malishevë, kryetari Begaj dhe koloneli Forte, i shprehën të kënaqur me gjendjes e sigurisë në Malishevë, pasi Malisheva vazhdon të mbetet njëri prej rajoneve më të sigurta në vend.

Brenda javës, zyrat e ofiqarisë në Malishevë me pamje të re

Malishevë, 28 shtator

Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Ragip Begaj, sot ka mbajtur mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, të cilët kanë raportuar për punët dhe aktivitetet e tyre gjatë javës së shkuar dhe për aktivitetet e javës në vazhdim. Në këtë mbledhje u bë e ditur se brenda dy ditëve, zyrat e ofiqarisë, do të jenë me pamje të re, ku shërbimi do të jetë me efikas, pas ridizajnimit të këtyre zyrave.

“Sot dhe nesër, pritet të përfundoj në tërësi projekti i rregullimit të zyrave të ofiqarisë, të cilat do të kenë pamje tjetër dhe qasja e qytetarëve do të jetë me e lehtë. Kjo është bërë me qëllim të ofrimit të shërbimeve më të shpejta dhe më efikase për qytetarët”, ka thënë drejtori i administratës, z.Sami Kafexholli.

Përndryshe, edhe drejtorët tjetër raportuan për aktivitetet e tyre dhe projektet në realizim e sipër, ku u tha se shumica e projekteve tashmë kanë përfunduar, ndërsa disa tjera janë drejt përfundimit, edhe pse reshjet atmosferike të ditëve të fundit, i kanë penguar disa projekte, të cilat realizohen në hapësirë të hapur, siç janë rrugët, kanalizimet, dhe të ngjashme.

Drejtori për buxhet dhe financa, z.Vesel Krasniqi, njoftoi se buxheti komunal 2016-2018, do të shqyrtohet në dy lexime në mbledhjet e Asamblesë Komunale, në dy ditët në vijim.

“Këtë të mërkure, QKMF e Malishevës shënon ditën e saj, si dhe do të mbahet edhe një Akademi Përkujtimore, me rastin e 17 vjetorit të rënies së dëshmorit të kombit dr.Shpëtim Robaj, emrin e të cilit e mban edhe QKMF e Malishevës”, ka njoftuar drejtori i shëndetësisë, z.Hajdin Berisha.

Kryetari Begaj, takoi banorët e Drenocit

Malishevë, 28 shtator



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, i shoqëruar nga drejtori i urbanizimit, z.Skënder Rrahmanaj, ai i shërbimeve publike z.Milazim Morina dhe përgjegjësi i njësisë së Hidroregjionit në Malishevë, z.Njazi Bytyçi, janë takuar sot me banorët e fshatit Drenoc, për ti dëgjuar problemet dhe nevojat që kanë banorët e këtij fshati, i cili është edhe vendbanimi më i madh në Komunën e Malishevës.

“Jemi përpjekur të kryejmë punë, me aq sa kemi pasur mundësi financiare, pasi si komunë, kemi një buxhet mjaft të varfër, mirëpo kemi arrit ta ndërtojmë rrjetin e ujësjellësit, pastaj rreth katërmijë metra kanalizim, disa rrugë, fusha sporti për shkollat dhe disa investime tjera. E di që uji nuk mjafton, por jemi duke bërë përpjekje maksimale, që ujësjellësin e fshatit tuaj, ta lidhim me ujësjellësin në Senik, por që edhe aty na kanë disa probleme, pasi dikush qëllimisht i ka dëmtuar pusët, mirëpo ne jemi duke i rregulluar dhe besoj që shumë shpejt, do të arrijmë ta rregullojmë këtë dhe sisteme tjera”, tha kryetari Begaj në fjalën e tij. “Të gjitha programet tona nuk mund të realizohen menjëherë, por ato janë në proces të realizimit dhe në këtë drejtim, edhe për ujësjellës, ne si komunë, i kemi kryer obligimet tona, ndërsa me kanalizim e di që ka problem, jo vetëm në fshatin tuaj, por ne do të vazhdojmë të investojmë

në këtë drejtim dhe të gjitha fshatrat, përfshi edhe Drenocin, do të lidhen me derdhjen e kanalizimit, në kolektorin kryesor ujërave të zeza”, tha Begaj.

“Uji për pije dhe kanalizimi, janë dy nevojat më të mëdha për këtë fshat, ku sipas banorëve, edhe pse është i ndërtuar rrjeti ujësjellësit, banorët ende nuk kanë furnizim të rregullt me ujë, ndërsa në disa lagje ujë nuk shkon fare, kurse edhe kanalizimi i fshatit ka nevojë të riparohet në disa vende dhe të zgjatet rrjeti, pasi rreth katër mijë metra kanalizim të ndërtuara, nuk mjaftojnë për nevojat e fshatit, për shkak të madhësisë dhe shpërndarjes që kanë lagjet”, tha kryetari i fshatit Drenoc, z.Kapllan Krasniqi.

Edhe banorët tjerët e fshatit, u shprehën për nevojat e tyre, por që ujësjellësi dhe kanalizimi, ishin nevojat më kryesore, për këtë fshat, pasi në disa raste ka edhe keqpërdorime, por kanë shprehur edhe pakënaqësi për menaxhimin e ujësjellësit.

Për çështjen e ujësjellësit, foli edhe përgjegjësi i njësisë së Hidroregjionit në Malishevë, Njazi Bytyçi, sipas të cilit, në shumë raste ka keqpërdorime, të cilat edhe ato kapacitete të ujit, po e pengojnë seriozisht, dhe kërkoi për përkrahje nga banorët, për të evituar problemet, në mënyrë që banorët të kenë ujë, së paku disa orë në ditë, përfshi edhe lagjet ku nuk arrijnë të shkojnë ujë.

Ndërsa drejtori i urbanizimit, i njoftoi banorët për planifikimet e Komunës së Malishevës, për investime, përfshi edhe Drenocin, ku tha se do të vazhdohet me rregullimin e sistemit të kanalizimit dhe investime tjera.

KK i Malishevës vazhdon me përkrahjen për familjet e dëshmorëve

Malishevë, 30 shtator



Kuvendi i Komunës së Malishevës, i drejtuar nga kryesuesi i saj, z.Aziz Thaçi, dje ka filluar mbajtjen e mbledhjes së nëntë të rregullt të këtij vitit, ku në mesin e shumë pikave të rendit të ditës, ka marrë dy vendime, e para për vazhdimin e përkrahjes për familjet e dëshmorëve të rënë në trojet shqiptare, si dhe ka miratuar projekt rregulloren për tatimin mbi pronën e paluajtshme.

Fillimisht anëtarët e Kuvendit të Komunës së Malishevës, unanimisht miratuan kërkesën e kryetarit të komunës, për vazhdimin e përkrahjes financiare për familjet e dëshmorëve të rënë në trojet shqiptare dhe të cilat nuk kanë një përkujdesje shtetërore.

Pas shqyrtimit dhe propozimeve për disa ndryshime, anëtarët e KK të Malishevës, kanë miratuar edhe projekt rregulloren për tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin 2016.

Para anëtarëve të KK të Malishevës, ka raportuar edhe drejtori për arsim dhe edukim, lidhur me përfundimin e vitit shkollor 2014/2015 dhe për fillimin vitit të ri shkollor 2015/2016. Po ashtu KK i Malishevës, ka shqyrtuar në lexim të parë edhe projekt buxhetin 2016-2018, me theks të veçantë për vitin 2016.

Miratimi i buxhetit, i cili para anëtarëve të KK-së, u prezantua në dy versione, i pari sipas kufijve buxhetor të përcaktuar nga MEF-i dhe i dyti sipas vejave reale të komunës.

Projekt buxheti dhe pikat tjera të parapara për këtë mbledhje, pritet të miratohen, përkatësisht të shqyrtohen gjatë ditës së sotme, në vazhdimin e seancës së rregullt të KK të Malishevës.

Mbledhja e nëntë e rregullt e KK të Malishevës është mbajtur në sallën e meremetuar të saj, ku tani anëtarët e kuvendit, anëtarët e qeverisë komunale dhe publiku, kanë kushte më të mira për punë dhe zhvillim të mbledhjeve.

Malisheva miratoi buxhetin me vërejtje sipas nevojave të komunës

Malishevë, 30 shtator



Kuvendi i Komunës së Malishevës, në mbledhjen e sotme, me shumicë të votave e ka miratuar projekt buxhetin 2016-2018, por me vërejtjet e saj. Vërejtjet kanë të bëjnë me nevojat e komunës dhe jo vetëm sipas kufijve buxhetor të parapërcaktuar nga ana e Ministrisë për Ekonomi dhe Financa.

Vërejtjet e Kuvendit të Komunës së Malishevës, kishin të bëjnë kryesisht me përcaktimin e kufijve për paga dhe meditje, ku komunat, sipas MEF janë në minus nga viti i ardhshëm, pastaj përcaktimi i kufirit të të hyrave vetanake, ku Malishevës, i është përcaktuar një shumë, që sipas drejtorisë së financave dhe kuvendarëve, është e paarritshme, si dhe është

kërkuar kthimi i buxhetit së Qendrës së Kompetencës, nga agjencioni i arsimit profesional, tek buxheti i komunës.

Përndryshe, sipas drejtorit për buxhet dhe financa, z.Vesel Krasniqi, buxheti total për vitin 2016 është rreth 12 milion e 373 mijë euro, kurse buxheti i përcaktuar për investime kapitale, është 3 853 849 euro, ku projektet e parapara për vitin e ardhshëm, janë hartuar, duke u bazuar nga kërkesat e qytetarëve, planifikimi i qeverisë komunale dhe kërkesat e Kuvendit të Komunës.

Duke u bazuar në këto investime të planifikuara, për vitin 2016, parashihen të investohet në arsim dhe shkencë 504 833 euro, në shërbime shëndetësore 231 533 euro, në bashkëfinancim me qytetar 314 233 euro, në bujqësi 350 mijë euro, në infrastrukturë rrugore 430 mijë euro dhe në planifikim urban dhe mjedis, ku edhe hyjnë shumica e projekteve, janë planifikuar 2 023 250 euro.

Në 17 vjetorin e rënies përkujtohet dëshmori dr.Shpëtim Robaj

Malishevë, 30 shtator



Sot në Malishevë, organizuar nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF), është mbajtur një akademi përkujtimore, me rastin e 17 vjetorit të rënies së dëshmorit të kombit, anesteziologut Shpëtim Robaj, emrin e të cilit mban edhe kjo qendër shëndetësore.

Në këtë akademi morën pjesë, ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, z.Ferid

Agani, nënkryetari i Komunës së Malishevës, z.Rexhep Mazreku, përfaqësues të mistrisë së shëndetësisë, të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), kryesuesi i KK të Malishevës, z.Aziz Thaçi, përfaqësues të shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve, familjarë, bashkëpunëtor, përfaqësues të partive politike në Malishevë, dhe qytetar të shumtë.

Me këtë rast, nga folësit, u çmua lartë jeta dhe vepra e dr.Shpëtim Robajt, kontributi i tij në organizimin e spitaleve ushtarake të UÇK-së, përkujdesja nga plagosurve gjatë kohës së luftës, guximi dhe trimëria e treguar, deri në ditën e 30 shtatorit të vitit 1998, kur në përpjekje për tu ofruar ndihmë të plagosurve në masakrën e Abrisë, vetura bie në mina, ku edhe gjen vdekjen dr.Shpëtim Robaj.

“Bijtë dhe bijat e Komunës së Malishevës, dëshmuar që i takojnë historisë dhe lavdisë kombëtare, dhe këtë nam e arritën me sakrificën e tyre sublime. Në mesin e këtyre, është

edhe dr.Shpëtimi, i cili më shumë e deshi lirinë se jetën e tij. Vepra e tij i bën dritë lirisë sonë, i bën mjekësisë dhe ishte shembull i atdhedashurisë”, tha mes tjerash në fjalën e tij, nënkryetari i Malishevës, z.Rexhep Mazreku.

Ndërsa ministri i MMPH, z.Ferid Agani, tha se veprat e njerëzve të mirë, shkojnë duke u rritur. “Shpëtimi ishte shembull i rrallë i përkushtimit profesional në shëndetësi. Ishte i përkushtuar ndaj të sëmurit, ndaj njerëzve në nevojë, dhe sot është shembulli më i mirë për gjenerata e reja në mjekësi”, tha ministri Agani.

Për jetën, veprimtarin e tij gjatë luftës së UÇK-së, folën bashkëpunëtorët e tij, të cilët sollën kujtime të angazhimit të dr.Shpëtim Robajt.

Në emër të familjes, e bija Erleta Robaj, i falënderoi të gjithë për këtë organizim dhe pjesëmarrje, në kujtim jo vetëm të prindit të saj, por të të gjithë dëshmorëve të kombit.

Më pas, në oborrin e QKMF “Dr.Shpëtim Robaj” në Malishev, janë bërë nderime dhe janë vendosur lule, pranë bustit të dr.Shpëtim Robaj.

KK i Malishevës, kundër formimit të Asociacionit të Komunave Serbe

Malishevë, 30 shtator

Kuvendi i Komunës së Malishevës, ka miratuar një deklaratë, kundër formimit të Asociacionit të Komunave Serbe. Kjo deklaratë, është iniciuar nga Lëvizja “Vetëvendosje!”, përkatësisht anëtari i Kuvendit të Komunës nga radhët e VV, z.Valon Hoti.

Në vazhdim deklarata e propozuar nga ana e kuvendarit Valon Hoti:

Në mbështetje të dispozitave të Nenit 12 paragrafit 2 pikës d, lidhur me Nenin 40 paragrafi 2 pika l të Ligjit NR. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Nenin 10 pikës 2 të Statutit të Komunës së Malishevës, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e datës 30.09.2015 miraton këtë:

DEKLARATË

1. *I ashtuquajturit Asociacioni/“Zajednica” i/e komunave me shumicë serbe shprehë themelimin e një etniteti juridik të themeluar mbi bazën e pastrimit etnik të shqiptarëve.*
2. *Themelimi i një Asociacioni të tillë, krahas dëmit juridiko-administrativ dhe organizimit shtetëror që i bënë Republikës së Kosovës si shtet me karakter unitar të përkufizuar me Kushtetutë, juridizon formalizimin e një strukture juridike me tipare etnike. Me këtë karakter tani më të përkufizuar me Marrëveshjen e Brukselit dhe me marrëveshjen e fundit të datës 25 gusht 2015, Republika e Kosovës po bëhet shtet diskriminues ndaj shumicës shqiptare, por edhe ndaj qytetarëve të tjerë që janë shtetas të Republikës së Kosovës.*

3. *Themelimi i këtij Asociacioni/Zajednicë me pushtet të ndërmjetëm e tejkalon çdo qëllim të organizimit të pushtetit lokal si organizim themelor administrativ. Qëllimi i këtij etniteti legal nuk është asgjë tjetër veçse një strukturë formale me baza etnike që përjashton të gjithë qytetarët të tjerë që nuk janë të përkatësisë kombëtare serbe.*
4. *E themeluar me përmbajtje tërësisht në kundërshtim me Kushtetutën e Republikë së Kosovës, legjislacionin pozitiv nga fusha e organizimit të pushtetit lokal dhe atij përkitazi me financat publike të pushtetit lokal, Kartës Evropiane Për Vetëqeverisje Lokale (Strasburg, 15 tetor 1985).*
5. *Kuvendi i Komunës së Malishevës nxjerrë qëndrim për arsyet e mësipërme:*

5.1 Kuvendi i Komunës së Malishevës nuk do të njoh një formacion juridik i quajtur Asociacion/ "Zajednicë" e Komunave me Shumicë Serbe, duke përfshirë vendimet që do të merren nga organet e këtij konstruksioni formal kundërkushtetues;

5.2 Kuvendi i Komunës së Malishevës zotohet se nuk do të mbajë asnjë raport me strukturat e këtij organizimi kriminal dhe me prapavijë të spastrimit etnik;

5.3 Kuvendi i Komunës së Malishevës i bënë thirrje Qeverisë së Kosovës që të heqë dorë nga cilido veprim i cili do t'i kontribuojë themelimit të Asociacionit/"Zajednicës";

5.4 Kjo Rezolutë do të hyjë në fuqi ditën e miratimit të saj nga Kuvendi i Komunës së Malishevës.